REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Zyra Ekzekutive – Komisioni i Pavarur i Mediave

# RAPORT MONITORIMI

## OSHMA-TË GJATË FUSHATËS PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Periudha e monitorimit 16 shtator – 17 tetor 2021

2 nëntor 2021, Prishtinë

## Përmbajtja


**I. Përmbledhje Ekzekutive ..... 5**

**II. Baza Ligjore ..... 6**

**III. Metodologjia dhe realizimi ..... 7**

**IV. Gjetjet nga monitorimi ..... 8**

**V. Shkeljet e gjetura ..... 13**

**VI. Veprimet e KPM-së lidhur me Zgjedhjet ..... 16**

**VII. Ankesat ..... 20**

**VIII. Hapësira e ofruar për SCP-të ..... 21**

1. OSHMA-të me mbulim tokësor nacional ..... 22
    - RTK1 ..... 22
    - TV 21 ..... 27
    - KTV ..... 32
2. OSHMA-të me mbulim tokësor lokal/regjional ..... 37
    - TV DUKAGJINI ..... 37
    - SYRI VISION ..... 42
    - TV FESTINA ..... 45
    - TV TEMA ..... 47
    - TV BESA ..... 49
    - TV MOST ..... 50
    - TV PRIZRENI ..... 51
3. OSHMA-të që operojnë përmes OSH-ve ..... 55
    - KLAN KOSOVA ..... 55
    - TE7 ..... 60
    - RTK2 ..... 64
    - KANAL 10 ..... 72
    - ATV ..... 77

**IX. Periudha e heshtjes zgjedhore ..... 83**

**X. Përfaqësimi gjinor gjatë zgjedhjeve ..... 83**

- TV21 ..... 85
- KTV ..... 86

TV DUKAGJINI ........................................................................................................ 87
TV SYRI VISION ...................................................................................................... 88
TV FESTINA ........................................................................................................... 89
TV PRIZRENI ......................................................................................................... 90
KLAN KOSOVA ...................................................................................................... 91
TE7 ......................................................................................................................... 92
RTK2 ....................................................................................................................... 93
KANAL 10 ............................................................................................................... 94
ATV ......................................................................................................................... 95
**XI. Sfidat dhe vështirësitë gjatë monitorimit të pajtueshmërisë së të licencuarve të KPM-së 96**
**XII. Konkluzione dhe rekomandime ........................................................................ 96**

## AKRONIMET E PËRDORURA NË RAPORT

- KPM - Komisioni i Pavarur i Mediave
- KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- DMA - Departamenti i Monitorimit dhe Analizës i KPM-së
- SCP - Subjekt Politik i Certifikuar
- OSHMA - Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizuel
- OSH - Operator i Shpërndarjes

## I. Përmbledhje Ekzekutive

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), duke qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës[1], që vlen edhe për Zgjedhjet Lokale[2], ka bërë monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuele (OSHMA) që kanë mbuluar fushatën e zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës.

Në Zgjedhjet Lokale, për kuvende komunale dhe kryetar të komunave, të mbajtura më 17 tetor 2021, kanë marrë pjesë tetëdhjetë e nëntë (89) subjekte politike të certifikuara (SCP), përfshirë parti politike, koalicione, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur:

GI Srpski Opstanak, Balli Kombëtar i Kosovës, Kosova Demokratik Türk Partisi, Pokret za Gora, Građanska Inicijativa Gore, Bošnjačka Inicijativa Peć, Patriot Rudari, Partia Balliste, Iniciativa Qytetare për Obiliq, Inicjativa Bošnjačkog Jedintsva, Radoš Repanović, Partia Demokratike e Unitetit, Lista e Pavarur Bekim Jashari, Jeton Salihu, Jugoslav Jovanović, Iniciativa Qytetare për Skenderaj, Kosova Adalet Türk Partisi, Iniciativa për Fushë Kosovë Egjiptian-Ashkali, Nisma Socialdemokrate, Iniciativa Qytetare për Mogillën, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Iniciativa Qytetare Progresi për Skenderaj, Koalicija Vakat, Partia Liberale Egjiptiane, Građanska Inicijativa Bošnjaka Istok, Ilyas Bayraktar, Partia Social Demokrate, Iniciativa Qytetare për Kllokot, Iniciativa Qytetare Bashkë Për Istogun, Isa Elezaj, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, Lista Ndryshe, Hajrush Stublla, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, Ne Mundemi, Socijaldemokratska Unija, Sladjana Pantović, Shukri Luta, Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës, Lëvizja për Bashkim, Selajtin Bytyqi, Partia e Drejtësisë, Jedinstvena Goranska Partija, Lëvizja Vetëvendosje!, GI Sloboda Štrpce, Forca e Diasporës, Srpska Lista, Hamdi Malaj, Aleanca Kosova e Re, Nova Demokratska Stranka, Yenilikçi Türk Hareket Partisi, Narodno Jedinstvo, Aleanca Shqiptare, Organizata Balli Kombëtar Demokrat, Branimir Stojanović, Iniciativa Erdem, Agim Gjeli, Dragan Repanović, Bashkë për Shtërpcën, Lidhja Demokratike e Kosovës, Narodna Sloga, Partia e Ashkalinjëve për Integrim, Rufki Suma, Reformimi Demokratik për Ferizajn, Iniciativa Qytetare Green për Drenas, Shqiptarët e Bashkuar, Partia Ura, Lulzim Bexheti, Unioni i Blakçorve, Bojan Saičić, Gani Veselaj, Gani Neziri, Fjala, Lëvizja Qytetare Vatra, Iniciativa Qytetare për Ndryshim, Xhafer Bytyqi, Partia Demokratike e Kosovës, Lista e Ashkalive, Naša Inicijativa, Milazim Lushaj, Građanska Inicijativa Zubin Potok, Demokratët për Drenasin, Smajl Mustafa, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, Iniciativa e Therandës, Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës, GI Srpska Narodna Sloga, Kastriot Bushi, Iniciativa Qytetare "Mitrovica".

Fushata zgjedhore ka zgjatur nga data 16 shtator deri më 15 tetor 2021, ndërsa zgjedhjet janë mbajtur më 17 tetor 2021.

Qëllim i monitorimit, për periudhën 16 shtator deri më 17 tetor 2021, ishte vlerësimi i performancës së OSHMA-ve në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje, të titulluar "Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve", si dhe Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së. Ky raport është realizuar nga Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA) i Zyrës Ekzekutive dhe prezanton

[1] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544
[2] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2549

të gjeturat nga monitorimi i OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe periudhës së heshtjes zgjedhore deri në mbylljen zyrtare të vendvotimeve.

Në monitorim janë përfshirë njëzet e dy (22) OSHMA, prej të cilëve:

- Tre (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- Katërmbëdhjetë (14) me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Liria, TV Festina, TV Prizreni, TV Besa, TV Mitrovica, TV Puls, TV Tema, TV Vali, TV Mir, TV Dukagjini, TV Syri, TV Herc, TV Most, TV Iliria); dhe
- Pesë (5) me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Kanal 10, ATV, Klan Kosova dhe TE7).

Dy OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Zoom dhe TV Opinion) nuk janë të përfshira në monitorim, pasi që nuk kanë qenë në transmetim për shkaqe teknike.

Gjatë procesit të monitorimit, në fokus ishin të gjitha format e prezantimit medial të fushatës zgjedhore si: edicionet e lajmeve, pikat politike reklamuese, kronikat zgjedhore dhe intervistat e debatet e transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00. Zyrtarët e Departamentit të Monitorimit dhe Analizës (DMA) gjatë periudhës monitoruese kanë vlerësuar: paanshmërinë në raportim, hapësirën e ofruar për SCP-të, gjuhën e përdorur dhe, në përgjithësi, pajtueshmërinë me Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve[3] dhe aktet tjera nënligjore përkatëse të KPM-së.

Nga të gjeturat e monitorimit rezulton se prezantimi i fushatës për zgjedhjet nga OSHMA-të, ishte kryesisht objektiv dhe i paanshëm, në pajtim me dispozitat për media në Ligjin për Zgjedhje dhe Kodin Etik për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio-Vizuele[4].

Gjatë periudhës zgjedhore në KPM janë adresuar katër (4) ankesa.

## II. Baza Ligjore

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton në mënyrë specifike dispozitat për "Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve". Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të këtij Ligji, KPM ka përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve (i publikuar edhe në ueb faqen e KPM-së[5]), i cili në fakt është interpretim më i detajuar i dispozitave të Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhje, e në të cilin janë përfshirë edhe dispozita ligjore të parapara në aktet nënligjore të KPM-së, përkatësisht në Kodin e Etikës për Ofruesit e

[3] https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Udh%C3%ABzues%20i%20KPM-s%C3%AB%20p%C3%ABr%20sjelljen%20e%20mediave%20gjat%C3%AB%20zgjedhjeve.pdf
[4] https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1476189555.8908.pdf
[5] https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3387

Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/035 dhe Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuele KPM 2017/07[6].

Sipas nenit 53 të Ligjit për Zgjedhje, KPM siguron që të licencuarit mirëmbajnë ditarë për të regjistruar kohën e emetimit dhe ekspozimeve tjera në media, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilin SCP. Për këtë qëllim, KPM u ka dërguar të licencuarve edhe format e ditarëve me dhe pa pagesë si dhe udhëzuesin për mënyrën e plotësimit të tyre, të cilat janë në dispozicion edhe në ueb-faqen e KPM-së[7]. Gjithashtu, KPM ka kërkuar nga OSHMA-të të njoftojnë nëse do të mbulojnë periudhën e fushatës zgjedhore gjatë Zgjedhjeve Lokale.

## III. Metodologjia dhe realizimi

Metodologjia e përdorur gjatë monitorimit të performancës së ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuele është bazuar në analizë sasiore dhe cilësore, me theks të veçantë në edicionet qendrore të lajmeve, kronikat zgjedhore, pikat reklamuese politike si dhe intervista e debate në përmbajtjet programore të transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Metodologjia e monitorimit ka konsistuar në regjistrimin e programeve, kategorizimin e tyre, si dhe matjet e kohës/hapësirës për sekondë të dedikuar për secilin SCP. Për këtë qëllim janë futur të dhëna në tabelat e dizajnuara paraprakisht, vlerësimi i prezantimit të fushatës nëse ka qenë pozitiv, negativ apo neutral, përpunimi dhe analiza e të dhënave të fituara dhe në fund hartimi i raportit final lidhur me mbulimin medial të fushatës zgjedhore. Nxjerrjen e këtyre të dhënave e mundësoi sistemi i monitorimit të cilin e posedon KPM, përmes të cilit bëhet pranimi, incizimi dhe arkivimi i programeve të transmetuara të OSHMA-ve. Ndërsa, në rastet kur për shkaqe teknike nuk ka pasur regjistrim të ndonjë përmbajtje të caktuar, DMA ka kërkuar arkivën nga OSHMA-të. Matja e hapësirës së dedikuar SCP-ve, është bërë duke llogaritur kohën në sekonda në lajme, kronika zgjedhore, debate dhe intervista, për periudhën prej datës 16 shtator deri më 15 tetor 2021, nga ora 16:00 deri 24:00. Bazuar në këto llogaritje, janë dhënë tabelat për kohën e ofruar për SCP-të, në sekonda dhe përqindje.

Analizat cilësore janë bërë për të vlerësuar nëse:

- OSHMA-të kanë raportuar në mënyrë të drejtë, korrekte, objektive dhe të paanshme;
- OSHMA-të kanë ofruar mundësi për promovimin e platformave politike të SCP-ve në garë;
- OSHMA-të kanë ofruar qasje të njëjtë për SCP-të në debate/intervista, pyetje të njëjta, mundësi për replikë në emisione debatuese, renditje të aktiviteteve zgjedhore në lajme dhe kronika zgjedhore (renditja me rotacion duke mos favorizuar prezantimin e aktiviteteve të SCP-ve me renditje të njëjtë për çdo ditë të fushatës); dhe

[6] https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1514284325.0124.pdf
[7] https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3387

- OSHMA-të kanë vepruar në pajtueshmëri me heshtjen zgjedhore dhe dispozitat tjera të Ligjit për Zgjedhje.

Po ashtu, gjatë analizës është bërë edhe vlerësimi për mënyrën e prezantimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe standardet profesionale të gazetarisë (nëse ka pasur nxitje të urrejtjes, gjuhë të papërshtatshme, denigruese, fyerje, shpifje apo shkelje të dispozitave tjera të dhëna në Kodin e Etikës) si dhe pajtueshmërinë me Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.

Kohëzgjatja dhe të gjeturat në këtë raport përfshijnë periudhën e monitorimit nga data 16 shtator deri më 17 tetor 2021, përfshirë periudhën e fushatës zgjedhore dhe periudhën e heshtjes zgjedhore deri në mbylljen zyrtare të vendvotimeve.

Në monitorim janë përfshirë njëzet e dy (22) ofrues të shërbimeve mediale audiovizuele, prej të cilëve:

- Tri (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- Katërmbëdhjetë (14) me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Liria, TV Festina, TV Prizreni, TV Besa, TV Mitrovica, TV Puls, TV Tema, TV Vali, TV Mir, TV Dukagjini, TV Syri, TV Herc, TV Most, TV Iliria); dhe
- Pesë (5) me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Kanal 10, ATV, Klan Kosova dhe TE7).

Dy OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Zoom dhe TV Opinion), të cilët për shkaqe teknike nuk kanë qenë në transmetim, nuk janë përfshirë në këtë monitorim.

## IV. Gjetjet nga monitorimi

Gjatë fushatës zgjedhore, OSHMA-të kanë vepruar kryesisht në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, respektivisht Kreun VIII-të këtij Ligji, që vlen edhe për zgjedhjet lokale. Në përgjithësi, përmes përmbajtjeve programore, OSHMA-të kanë ofruar përfaqësim të drejtë dhe të paanshëm, në kuptimin e hapësirës së dhënë SCP-ve, ku kryesisht janë mbuluar SCP-të që kanë zhvilluar më tepër aktiviteteve zgjedhore.

Zgjedhjet Lokale 2021 janë karakterizuar më ndryshe sa i përket tubimeve elektorale dhe shpalosjes së programit politik, për shkak të pandemisë COVID 19. Shpalosjet e programeve politike janë paraqitur edhe në formë dixhitale pa prani kolektive të individëve fizikisht.

Ndërsa, raportimi i OSHMA-ve gjatë mbulimit të fushatës ishte kryesisht neutral dhe gjuha e përdorur gjatë kësaj fushate ka qenë në pajtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale.

Sa i përket reklamimit politik, është gjetur se gjatë kësaj periudhe janë transmetuar pika reklamuese politike në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhje, përkatësisht

pika politike reklamuese të paidentifikuara sipas përkufizimeve të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhje dhe Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve.

Raste të mos identifikimit të organizatës / individit përgjegjës apo nëse janë me apo pa pagesë për pikat reklamuese politike janë transmetuar në:

- RTK1 (spotet e SCP-ve: PDK, PSD, Lëvizja Qytetare Vatra, LDK, AKR, AAK, IQO (Xhafer Gashi), IQM, PRBK, URA, LPRK, të transmetuara gjatë datës: 24 shtator dhe 2, 3, 5-10 tetor 2021);
- TV Dukagjini (spoti i SCP LDK, i transmetuar më 24 shtator dhe 7 tetor 2021);
- TV Syri Vision (spoti i SCP LDK, i transmetuar më: 5, 14, 15 tetor 2021);
- TE7 (spotet e SCP-ve: PDK, AAK, LDK, të transmetuara gjatë datës: 20-30 shtator, 1-4 tetor 2021 dhe 7-15 tetor 2021).

Edhe gjatë kësaj periudhe të fushatës zgjedhore janë transmetuar pika reklamuese politike me prezencë apo prani të fëmijëve, në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. Raste të tilla janë gjetur gjatë transmetimit të dy spoteve të SCP PDK në:

- RTK1 (04 tetor 2021);
- TV21 (11-14 tetor 2021);
- KTV (08 dhe 15 tetor 2021);
- ATV (11 tetor 2021);
- Klan Kosova (8, 9, 11, 12, 14 tetor 2021);
- Kanal 10 (8, 9, 11, 12, 14,15 tetor 2021); dhe
- TE7 (9-11 tetor dhe 14 tetor 2021).

Pas njoftimeve për shkelje, ATV i është përgjigjur njoftimit duke larguar nga transmetimi materialin në fjalë dhe duke kërkuar falje për këtë lëshim, ndërsa RTK1 nuk ka transmetuar më materialin në fjalë.

Sa i përket Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, dy shkelje janë vërejtur edhe lidhur me nenin 11, paragrafi 2, gjatë transmetimit të një kronike në lajmet e TV Most, më datën 13 tetor 2021, e cila është ritransmetuar edhe në TV Puls, në të cilat gazetarët gjatë raportimit në vend të termit Kosovë kanë përdor termin *"Kosova i Metohija"*, që sipas Kodit të Etikës konsiderohet si gjuhë që cenon interesin nacional. Pas njoftimit për shkelje, TV Most ka kërkuar falje lidhur me këtë transmetim, duke u arsyetuar për gabimin dhe duke cekur se do të ndërmarrin masa që shkelje të tilla të mos përsëriten nga ana e tyre. Ndërsa, TV Puls ka sqaruar se shkelja ka ndodhur gjatë ritransmetimit të kronikës të lajmeve të TV Most.

Në kundërshtim me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audiovizuele, është vërejtur se gjatë kësaj periudhe janë transmetuar programe të çështjeve aktuale (programe dhe debate politike), në të cilat ka pasur reklamim me ekran të ndarë, kanë qenë të sponsorizuara si dhe ka pasur vendosje të produktit.

Reklamimi me ekran të ndarë, në kundërshtim me nenin 12, paragrafi 1, të kësaj Rregulloreje, janë vërejtur në OSHMA-të:

Klan Kosova

- Emisioni “Info Magazinë”, i transmetuar më: 16, 17, 20-24, 27-30 shtator dhe 1, 4-8, 11, 12, 14, 15 tetor 2021;
- Emisioni “Rubikon”, i transmetuar më: 16, 17, 20-24, 27, 28, 30 shtator dhe 1, 4-8, 11, 12, 14, 15 tetor 2021.

TV Dukagjini

- Emisioni “Debat Plus”, i transmetuar më: 16-30 shtator dhe 1-15 tetor 2021.

Kanal 10

- Emisioni “Prime Time”, i transmetuar më: 16-24, 26-30 shtator dhe 1, 2, 5-11, 13, 14 tetor 2021.
- Emisioni “Politiko”, i transmetuar më: 16-24, 26-30 shtator dhe 1-6, 8-15 tetor 2021.

TE7

- Emisioni “Presing” dhe “DPT te Fidani”, të transmetuara më: 17, 21-24, 27-30 shtator dhe 1-15 tetor 2021.

ATV

- Emisioni “Direkt”, i transmetuar më datën 15 tetor 2021. Pas njoftimit për shkelje, ATV nuk ka transmetuar reklamim me ekran të ndarë në këtë program.

Në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 3, të kësaj Rregulloreje, shkelje janë vërejtur në:

Klan Kosova

- Emisioni “Rubikon”, i transmetuar më: 16, 17, 20-24, 27, 28, 30 shtator dhe 1, 4-8, 11, 12, 14, 15 tetor 2021.

TV Dukagjini

- Emisioni “Debat Plus”, i transmetuar më: 16-24, 26-30 shtator dhe 1-15 tetor 2021.

Kanal 10

- Emisioni “Prime Time”, i transmetuar më: 16-24, 26-30 shtator dhe 1, 2, 5-11, 13, 14 tetor 2021.
- Emisioni “Politiko”, i transmetuar më: 16-24, 26-30 shtator dhe 1-6, 8-15 tetor 2021.

TE7

- Emisioni “Presing” dhe “DPT te Fidani”, të transmetuara më: 17, 21-24, 27-30 shtator dhe 1-15 tetor 2021.

Ndërsa, vendosje e produktit, në kundërshtim me nenin 15, është vërejtur në:

KTV

- Emisioni “60 Minuta”, i transmetuar më 22 shtator dhe 11 tetor 2021.
- Emisioni “Zgjedhjet në Kohë”, i transmetuar më 22 shtator 2021.

Klan Kosova

- Emisioni “Info Magazinë”, i transmetuar më: 16, 17, 20-24, 27-30 shtator dhe 1, 4-8, 11, 12, 14, 15 tetor 2021;
- Emisioni “Rubikon”, i transmetuar më: 16, 17, 20-24, 27, 28, 30 shtator dhe 1, 4-8, 11, 12, 14, 15 tetor 2021.
- Emisioni “Edicioni special”, më vonë për shkak të zgjedhjeve i emëruar “Edicioni zgjedhor”, i transmetuar më: 16, 17, 20-28, 30 shtator dhe 1-7, 10-12, 14, 15 tetor 2021.

TV Dukagjini

- Emisioni “Debat Plus”, i transmetuar më: 16-24, 26-30 shtator dhe 1-15 tetor 2021.

Kanal 10

- Emisioni “Prime Time”, i transmetuar më: 16-24, 26-30 shtator dhe 1, 2, 5-11, 13, 14 tetor 2021.
- Emisioni “Politiko”, i transmetuar më: 16-24, 26-30 shtator dhe 1-6, 8-15 tetor 2021.

TE7

- Emisioni “Presing” dhe “DPT te Fidani”, të transmetuara më: 17, 21-24, 27-30 shtator dhe 1-15 tetor 2021.

TV Festina

- Emisioni “Progres”, i transmetuar më: 7, 14 dhe 15 tetor 2021.

Ndërsa, gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, që ka filluar njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendvotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendvotimeve, me përjashtim të disa rasteve, OSHMA-të kanë vepruar në pajtim me nenin 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme. Gjatë ditës së votimit, në përgjithësi OSHMA-të kanë raportuar rreth mbarëvajtjes së procesit zgjedhor, përfshirë këtu mbulimin e konferencave të KQZ-së, intervista me përfaqësues të qendrave të votimit, qytetarë etj..

Gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, rastet e shkeljeve të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhje, janë vërejtur në:

RTK1 (17 tetor 2021)

- Gjatë transmetimit të drejtpërdrejt të dy konferencave për media të SCP-ve LDK dhe PDK, ku janë shfaqur edhe llogo të tyre. RTK ka dërguar sqarim duke theksuar se për shkak të volumit të madh të punës në ditën e zgjedhjeve, ka ndodhur gabim i natyrës teknike (pamundësi teknike për të evituar llogot e partive gjatë transmetimit të drejtëpërdrejt dhe ka theksuar se do të sigurohen që raste të tilla të mos përsëriten.

TV 21 (17 tetor 2021)

- Gjatë transmetimit të drejtpërdrejt të dy konferencave për media të SCP-ve LDK dhe PDK, ku janë shfaqur edhe llogo të tyre.
- gjatë transmetimit të momenteve të votimit të kandidatit për Kryetar të Prishtinës nga SCP PDK (z. Uran Ismaili), me ç'rast dëgjohet thirrja e sloganit që kandidati ka përdorur gjatë fushatës *"ma gjallë, ma gjallë"*. Kjo është transmetuar dy herë gjatë ditës.

KTV (16 tetor 2021)

- Gjatë reprizimit të emisionit informativ "60 minuta", i datës 15 tetor 2021, me dy kandidatë për Kryetar të Prishtinës nga SCP-të: Fjala dhe PB. Përmes një shkrese, KTV ka njoftuar se ka qenë lëshim teknik dhe se programi është ndërprerë pas disa minutave. Në bazë të monitorimit, emisioni në kohëzgjatje prej 33 minutash ishte ndërprerë pas 12 minutash transmetimi.

Klan Kosova (17 tetor 2021)

- Gjatë deklaratës pas votimit të kandidatit për Kryetar të Prishtinës nga SCP AKR (z. Gëzim Mehmeti), ku kandidati në mes tjerash thekson "*Prishtina meriton Gëzim*, *Prishtina Gëzuar*!", Moderatorët e emisionit e diskutojnë nëse deklarata e tij mund të jetë shkelje e heshtjes zgjedhore dhe drejtpërdrejt bëjnë thirrje publike për të gjithë kandidatët të kenë kujdes gjatë deklarimeve të tyre sepse Klan Kosova duhet t`ua ndërpres fjalën për shkak të heshtjes zgjedhore.
- Gjatë deklaratës pas votimit të kandidatit për Kryetar të Mitrovicës së Jugut nga SCP LVV (z. Agim Bahtiri), me ç'rast kandidati në mes tjerash thekson "*iu shpreh dëshirat më të sinqerta nga kryetari i juaj dhe kryetari i ardhshëm i Mitrovicës"*. Moderatorët e emisionit e diskutojnë që deklarata e tij është shkelje e heshtjes zgjedhore. Klan Kosova ka dërguar sqarim lidhur me rastet e shkeljeve të heshtjes zgjedhore gjatë trasmetimit të deklaratave të z. Mehmeti dhe z. Bahtiri, sqaruar se kanë reaguar duke e sqaruar situatën nga moderatorët në studio.
- Gjatë transmetimit të drejtpërdrejt të dy konferencave për media të SCP-ve AKR dhe PDK, ku janë shfaqur edhe logo të tyre.
- Gjatë transmetimit të kronikave që kanë prezantuar deputetë që kandidojnë për kryetar të komunave, ku në sfond shihen llogot e partive, kandidati për Kryetar të Lipjanit nga SCP

LVV (z. Adnan Rrustemi) dhe kandidati për Kryetar të Podujevës nga SCP AAK (Besnik Tahiri).

Kanal 10 (17 tetor 2021)

- Gjatë deklaratës pas votimit të kandidatit për Kryetar të Prishtinës nga SCP AKR (z. Gëzim Mehmeti), ku kandidati në mes tjerash thekson "*Prishtina meriton Gëzim, Prishtina Gëzuar*!".
- Gjatë intervistave me qytetarë, me ç'rast njëri nga ta thekson se *"presim ndryshime të fitoj më i miri, tretë janë të mirë, kandidati ma i mirë është Bekim Azizi, (duke iu referuar kandidatit për Kryetar të Vitisë nga SCP PDK)"*. Pas kësaj, gazetari thekson që nuk duhet të përmenden emra sepse është heshtje zgjedhore.

TE7 (17 tetor 2021)

- Gjatë transmetimit të deklaratës së Kryetarit të Degës së SCP PDK (z. Sami Lushtaku), ku në mes tjerash i intervistuari thekson se *"PDK do të dal fituese, para se të përfundoj periudha e mbylljes zyrtare e vendvotimeve"*.
- Gjatë transmetimit të një interviste me babain e një sportisteje, me ç'rast i intervistuari, në mes tjerash, thekson se "*…ne qytetarët e Pejës jemi të kënaqur me punën që e ka bo kryetari deri tash, zgjedhja e popullit është a do ta vazhdoj, Prap po besoj që ai është një person i duhur i cili po punon për Pejën, po jep të gjitha me mundësitë e veta.." (duke iu referuar kandidatit të SCP LDK për Kryetar të Pejës)*".
- Gjatë trasnmetimit të një interviste me z. Ismet Hebibi, me ç'rast i intervistuari thekson *"Jam pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje", "Votoni Lëvizjen Vetëvendosje"*. Gazetari menjëherë ka ndërprerë intervistën duke paralajmëruar se shkelet heshtja zgjedhore.
- Gjatë deklaratës pas votimit të kandidatit për Kryetar të Podujevës nga SCP NISMA (z. Xhemajl Hasanaj), ku kandidati në mes tjerash thekson se *"Ja e sjell unë ndryshimin ja s`ka kush tjetër që e sjell"*.
- Gjatë transmetimit të konferencës për media të SCP PDK, me ç'rast është shfaqur llogo e SCP-së.
- Gjatë transmetimit të intervistës me ish Kryetarin e Gjilanit (z. Qemajl Mustafa), ku i intervistuari në mes tjerash thekson që "*Partia Demokratike e Kosovës ka njerëz të vlefshëm"*. Gazetarja ndërhyn menjëherë duke kërkuar që të mos përmenden emra të partive politike.

## V. Shkeljet e gjetura

Nga monitorimi i OSHMA-ve që kanë mbuluar fushatën zgjedhore është vërejtur se, me përjashtim të disa rasteve, OSHMA-të kanë vepruar në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje dhe Kodin e Etikës për Shërbimet Mediale Audiovizuele.

Shkeljet e evidentuara kanë të bëjnë me:

- Reklamimin politik, përkatësisht mos identifikimin e duhur të tyre;
- Përdorimin e fëmijëve në spote politike;
- Reklamimin me ekran të ndarë, sponsorizimin dhe vendosjen e produkteve në programe për çështje aktuale;
- Përdorim të shprehjeve / gjuhës në kundërshtim me Kodin e Etikës; dhe
- Shkeljen e periudhës së heshtjes zgjedhore.

Sa i përket reklamimit politik, është vërejtur se gjatë periudhës monitoruese janë transmetuar pika reklamuese politike të cilat nuk janë identifikuar nëse janë me apo pa pagesë, apo raste kur këto janë identifikuar se janë me apo pa pagesë por nuk janë identifikuar organizatat ose individët përgjegjës për to.

Në bazë të nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 03/L-073 përcaktohet që: *"Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin përgjegjës për të".*

Ndërsa, në Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve, përcaktohet se: *"Pavarësisht nëse reklamimi politik emitohet në kohën e blerë apo si pjesë e kohës pa pagesë të cilën ofruesi i shërbimit medial audiovizuel ua ofron subjekteve politike, teksti duhet të thotë se është "reklamim politik i sponsoruar nga [emri i partisë, organizatës, ose individi i cili ka paguar për kohën apo ka kërkuar pjesën e kohës pa pagesë]".*

Shkelje janë evidentuar edhe sa i përket përdorimit të fëmijëve në pika reklamuese politike. Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar vetëm dy pika reklamuese politike në të cilin ka pasur prezencë të fëmijëve.

Sipas Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, përkatësisht nenit 9, paragrafi 7, theksohet që: *"Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike."*

Sa i përket Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, shkelje janë vërejtur sa i përket formave të Komunikimeve Komerciale Audiovizuele si: sponsorizimi, vendosja e produktit dhe reklamimi me ekran të ndarë në programe të çështjeve aktuale, përkatësisht debateve zgjedhore.

Sipas paragrafit 1 të nenit 12 të kësaj Rregulloreje, thuhet se: *"Reklamimi me ekran të ndarë nuk duhet të jetë i tepërt në atë mënyrë që do t'ua pamundësonte shikuesve të vazhdojnë të shikojnë përmbajtjen editoriale dhe nuk duhet të përdoret në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale. Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me orarin dhe kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshopingut do të zbatohen për reklamimin me ekran të ndarë."*

Në bazë të nenit 31, paragrafi 4, të Ligjit për KPM-në, përcaktohet që: *"Programet e lajmeve dhe ngjarjeve aktuale nuk do të sponsorizohen".*

Ndërsa, sipas nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale theksohet se: "*Programet e lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale nuk do të sponsorizohen".*

Paragrafi 1 i nenit 15 thekson se: *"Vendosja e produkteve do të ndalohet".* Por, vendosja e produktit, sipas paragrafit 2, nënparagrafët 2 dhe 3, lejohet në programe të caktuara, duke përjashtuar programet informative dhe ato të çështjeve aktuale.

Pra, sipas nenit 2 përcaktohet se: *"Duke e përjashtuar paragrafin 6 të këtij neni, vendosja e produkteve do të jetë e lejueshme:*

*2.1. Në punimet kinematografike, filma dhe seri të bëra për shërbimet mediale audiovizuale;*

*2.2. Programet sportive dhe programet e lehta argëtuese, me përjashtim të programeve të fëmijëve."*

Sa i përket gjuhës së përdorur, gjatë transmetimit të lajmeve është gjetur një rast i përdorimit të shprehjes/gjuhës së përdorur nga ana e gazetarit/es në kundërshtim me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale. E njëjta kronikë e lajmeve është ritransmetuar edhe në një OSHMA tjetër.

Ndërsa, në periudhën e heshtjes zgjedhore, janë identifikuar kryesisht raste të shkeljeve gjatë:

- transmetimeve të deklaratave të kandidatëve për kryetar të komunave apo përfaqësuesve politik, për të cilat raste për shkak se janë transmetuar drejtpërdrejt disa nga të licencuarit kanë ofruar sqarime;
- transmetimeve të drejtpërdrejta të intervistave me qytetarë, ku disa prej të cilëve janë deklaruar për kandidatin/SCP-në për të cilat kanë preferenca, ndërsa në këto raste ka pasur ndërhyrje të gazetarëve me paralajmërime se nuk duhet përmendur emra për shkak të heshtjes zgjedhore;
- transmetimeve të drejtpërdrejta të konferencave për media të SCP-ve, me ç'rast janë shfaqur edhe llogo të këtyre subjekteve.

Sipas nenit 52.1 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje përcaktohet se: *"Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon 24 orë para hapjes së vendvotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendvotimeve".*

Neni 53 i Ligjit për Zgjedhje përcakton që: *"Komisioni i Pavarur për Media siguron se mediat mirëmbajnë një ditar për të regjistruar kohën e emetimit, dhe ekspozimeve tjera të mediave, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilën parti. Ditari i vlerëson të gjithë treguesit relevant të ekspozimeve, ndaras për secilin subjekt politik, sipas mënyrës së përcaktuar me rregullat e KPM-së".*

Sa i përket pajtueshmërisë së OSHMA-ve me nenin 53 të Ligjit për Zgjedhje, KPM pas pranimit dhe rishikimit të të dhënave të ofruara, do të vlerësojë pajtueshmërinë e të licencuarve me dispozitën ligjore të përcaktuar në këtë Ligj.

## VI. Veprimet e KPM-së lidhur me Zgjedhjet

Për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje, KPM para fillimit të fushatës zgjedhore, më 7 shtator 2021, ka njoftuar të licencuarit për mbajtjen e fushatës zgjedhore si dhe ka përcjell tek të licencuarit Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve. Po ashtu, njoftimi për zgjedhjet si dhe materiali zgjedhor, përfshirë këtu Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve, Format e Ditarëve me dhe pa pagesë, janë publikuar edhe në ueb-faqen e KPM-së.

Nga data 13 deri më 17 shtator 2021, KPM-ja ka organizuar pesë (5) takime regjionale[8] me të licencuarit e saj, ku ndër të tjera është diskutuar rreth procesit zgjedhor, përkatësisht obligimeve të mediave sipas Ligjit për Zgjedhje dhe akteve nënligjore të KPM-së gjatë proceseve zgjedhore. Takimet janë mbajtur në Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Prishtinë. Takimet regjionale janë mbështetur nga OSBE-ja, në kuadër të bashkëpunimit me KPM-në.

Përmes një komunikate për media, më 23 shtator 2021[9], KPM-ja ka kërkuar nga të licencuarit që t'i përmbahen rregullave që kanë të bëjnë me ndalimin e sponzorizimit, reklamimit me ekran të ndarë dhe vendosjes së produkteve në emisionet e lajmeve dhe programeve për çështje aktuale.

Më 28 shtator 2021, përfaqësuesit e KPM-së janë takuar me përfaqësuesen e Rrjetit Evropian të Organizatave Monitoruese të Zgjedhjeve (ENEMO), me të cilën është diskutuar rreth procesit zgjedhor, përkatësisht rolit dhe aktiviteteve që KPM-ja dhe ENEMO janë të angazhuar në këtë proces[10].

Më 15[11] dhe 17 tetor[12] 2021, përmes komunikatave për media, KPM-ja ka kërkuar nga të licencuarit që të respektohet obligimi ligjor i paraparë sipas nenit 52.1 të Ligjit për Zgjedhje, që ka të bëjë me heshtjen zgjedhore.

Lidhur me shkeljet e OSHMA-ve gjatë Zgjedhjeve Lokale, janë ndërmarr veprime ligjore si në vijim:

**- Për shkelje të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuele:**

1. **TV Dukagjini:** Shkresë më datë 23 shtator 2021, për shkelje të nenit 12, paragrafi 1, nenit 14, paragrafi 3, si dhe nenit 15 (Reklamim me ekran të ndarë, sponzorizim dhe vendosje e produkteve në programe të çështjeve aktuale).

[8] https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3391
https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3392
https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3394
https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3395
https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3396
[9] https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3399
[10] https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3402
[11] https://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3411
[12] https://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3413

2. **Klan Kosova:** Shkresë më datë 23 shtator 2021, për shkelje të nenit 12, paragrafi 1, nenit 14, paragrafi 3, si dhe nenit 15 (Reklamim me ekran të ndarë, sponzorizim dhe vendosje e produkteve në programe të çështjeve aktuale).

3. **TE 7:** Shkresë më datë 23 shtator 2021, për shkelje të nenit 12, paragrafi 1, nenit 14, paragrafi 3, si dhe nenit 15 (Reklamim me ekran të ndarë, sponzorizim dhe vendosje e produkteve në programe të çështjeve aktuale).

4. **KTV:** Shkresë më datë 23 shtator 2021, për shkelje të nenit 15 (Vendosje e produkteve në programe të çështjeve aktuale).

5. **Kanal 10:** Shkresë më datë 1 tetor 2021, për shkelje të nenit 12, paragrafi 1, nenit 14, paragrafi 3, si dhe nenit 15 (Reklamim me ekran të ndarë, sponzorizim dhe vendosje e produkteve në programe të çështjeve aktuale).

6. **TV Festina:** Shkresë më datë 11 tetor 2021, për shkelje të nenit 14, paragrafi 3, nenit 15 (Sponzorizim dhe vendosje e produkteve në programe të çështjeve aktuale).

7. **ATV:** Shkresë më datë 17 tetor 2021, për shkelje të nenit 12, paragrafi 1 (Reklamim me ekran të ndarë në programe të çështjeve aktuale).

**- Për shkelje të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, që vlen edhe për Zgjedhjet Lokale:**

1. **RTK 1:** Shkresë më datë 30 shtator 2021, për shkelje të nenit 49, paragrafi 6 (mos-identifikimi i dukur i pikave politike reklamuese).

2. **TV Dukagjini:** Shkresë më datën 30 shtator 2021, për shkelje të nenit 49, paragrafi 6 (mos-identifikimi i dukur i pikave politike reklamuese).

3. **TE 7:** Shkresë më datën 30 shtator 2021, për shkelje të nenit 49, paragrafi 6 (mos-identifikimi i dukur i pikave politike reklamuese).

4. **TV Syri Vision:** Shkresë më datën 6 tetor 2021, për shkelje të nenit 49, paragrafi 6 (mos-identifikimi i dukur i pikave politike reklamuese).

5. **KTV:** Njoftim për Shkelje të nenit 52, paragrafi 1, më datën 16 tetor 2021 (shkelje e heshtjes zgjedhore).

6. **TV 21:** Njoftim për Shkelje të nenit 52, paragrafi 1, më datën 17 tetor 2021 (shkelje e heshtjes zgjedhore).

7. **TE 7:** Njoftim për Shkelje të nenit 52, paragrafi 1, më datën 17 tetor 2021 (shkelje e heshtjes zgjedhore).

8. **Kanal 10:** Njoftim për Shkelje të nenit 52, paragrafi 1, më datën 17 tetor 2021 (shkelje e heshtjes zgjedhore).

9. **Klan Kosova:** Njoftim për Shkelje të nenit 52, paragrafi 1, më datën 17 tetor 2021 (shkelje e heshtjes zgjedhore).

10. **RTK 1:** Njoftim për Shkelje të nenit 52, paragrafi 1, më datën 17 tetor 2021 (shkelje e heshtjes zgjedhore).

**- Për shkelje të Kodit të Etikës 2016/03:**

1. **KTV:** Njoftim për shkelje më datën 12 tetor 2021, për shkelje të nenit 9, paragrafi 7 (pika politike reklamuese me prezencë të fëmijëve).

2. **RTK 1:** Njoftim për shkelje më datën 8 tetor 2021, për shkelje të nenit 9, paragrafi 7 (pika politike reklamuese me prezencë të fëmijëve).

3. **ATV:** Njoftim për shkelje më datën 13 tetor 2021, për shkelje të nenit 9, paragrafi 7 (pika politike reklamuese me prezencë të fëmijëve).

4. **TV Puls:** Njoftim për shkelje më datën 15 tetor 2021, për shkelje të nenit 11, paragrafi 2 (përdorim i gjuhës që cenon interesin nacional).

5. **TV Most:** Njoftim për shkelje më datën 15 tetor 2021, për shkelje të nenit 11, paragrafi 2 (përdorim i gjuhës që cenon interesin nacional).

6. **TV 21:** Njoftim për shkelje më datën 17 tetor 2021, për shkelje të nenit 9, paragrafi 7 (pika politike reklamuese me prezencë të fëmijëve).

Lidhur me shkeljet e OSHMA-ve gjatë procesit të Zgjedhjeve Lokale, Komisioni i KPM-së ka marrë këto vendime:

Më 18 tetor 2021[13]

[13] https://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3414

Komisioni i Pavarur i Mediave/Nezavisna Komisija za Medije/Independent Media Commission, Rr.Ul.Str. Perandori Justinian Nr. 124 Qyteza, Pejton, 10000 Prishtinë-Prištin- Pristina/Kosovë-Kosovo, Tel: (+381) (0) 38 245 031, Fax: (+381) (0) 38 245 034, E-mail: Info@kpm-ks.org; www.kpm-ks.org;

1. **TV Dukagjini:** Masë sanksionuese me gjobë 2.000€, për shkelje të nenit 12, paragrafi 1, nenit 14, paragrafi 3, dhe nenit 15 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073.
2. **Klan Kosova:** Masë sanksionuese me gjobë 2.000€**,** për shkelje të nenit 12, paragrafi 1, nenit 14, paragrafi 3, dhe nenit 15 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

3. **KTV:** Masë sanksionuese me gjobë 2.000€, për shkelje të nenit 15 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

4. **RTK 1:** Masë sanksionuese me gjobë 2.000€, për shkelje të nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073 dhe nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

5. **TE 7:** Masë sanksionuese me gjobë 2.000€, për shkelje të nenit 12, paragrafi 1, nenit 14, paragrafi 3, dhe nenit 15 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 dhe nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073.

6. **Kanal 10:** Masë sanksionuese me gjobë 2.000€, për shkelje të nenit 12, paragrafi 1, nenit 14, paragrafi 3, dhe nenit 15 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Më 20 tetor 2021[14]

1. **TV 21:** Masë sanksionuese me Vërejtje**,** për shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

2. **TE 7:** Masë sanksionuese me Vërejtje**,** për shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

3. **Kanal 10:** Masë sanksionuese me Vërejtje**,** për shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

4. **Klan Kosova:** Masë sanksionuese me Vërejtje**,** për shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

5. **RTK 1:** Masë sanksionuese me Vërejtje**,** për shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

6. **TV Puls:** Masë sanksionuese me Vërejtje**,** për shkelje të nenit 11, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

[14] https://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3418

7. **TV Most:** Masë sanksionuese me Vërejtje**,** për shkelje të nenit 11, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.

8. **TV Festina:** Masë sanksionuese me gjobë 1.000€**,** për shkelje të nenit 14, paragrafi 3, dhe nenit 15 të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07.

9. **ATV:** Masë sanksionuese me gjobë 1.000€**,** për shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 dhe nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07.

10. **TV 21:** Masë sanksionuese me gjobë 1.000€, për shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

## VII. Ankesat

Gjatë periudhës së Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, në KPM janë parashtruar katër (4) ankesa:

Rasti i parë është proceduar bazuar në Ankesën e Genc Hundozi, i cili ka përfaqësuar SCP LVV, ndaj OSHMA RTK 1. Ankesa i referohet një përmbajtje programore e cila pretendohet të jetë publikuar në facebook-un dhe portalin e RTK 1, dhe të jetë transmetuar në transmetuesin publik. KPM, me qëllim të shqyrtimit të ankesës, përkundër asaj që ankesa nuk ka qenë e specifikuar se në cilin kanal të transmetuesit publik është transmetuar përmbajtja programore, ka bërë monitorimin e kanaleve RTK 1, RTK2, RTK3 dhe RTK4 për datat 5 dhe 10 tetor 2021 dhe ka gjetur se në këto kanale nuk është transmetuar përmbajtja programore e cila është objekt i ankesës. KPM, më datën 19 tetor 2021, i ka dërguar palës ankuese përgjigje në ankesë duke e njoftuar se përmbajtja programore e cila është objekt i ankesës nuk është transmetuar në kanalet televizive të RTK-së.

